VENDIM
Nr. 37, datë 5.11.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 28.10.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 1 (L) 2021 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ledi Bianku, Odeta Kumbaro

SUBJEKT I INTERESUAR: Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish-ALUIZNI)

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj, konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave në gjykimin e çështjes administrative me nr. 31003-03330-00-2017, regjistruar në datën 10.11.2017, në Gjykatën e Lartë dhe konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.

BAZA LIGJORE: Neni 42, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, pika 1, dhe 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë palë paditëse në procesin gjyqësor me objekt detyrimin e palës së paditur, ALUIZNI-t Tiranë, të ndryshojë pjesërisht aktin administrativ për dosjen nr. 1198 prot., të përfundojë procedurat e legalizimit për pasurinë objekt gjykimi deri në dërgimin e dosjes për regjistrim përfundimtar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*) Kavajë, si dhe shpërblimin e dëmit për fitimin e munguar.

2. Me vendimin nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: "*Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Shfuqizimin e shkresës nr. 925/6 prot., datë 25.8.2015 të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimore Informale, Drejtoria Tirana 4. Detyrimin e palës së paditur ALUIZNI-t që të përmbyllë procedurat për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin mbi parcelën ndërtimore në lidhje me shtetasit Ledi Bianku dhe Odeta Kumbaro, sipas kontratës nr. 2017 rep., nr. 690 kol., datë 6.3.2012. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të padisë.*". Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 998 (86-2016-965), datë 13.3.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë pala e paditur në procesin gjyqësor, kurse kërkuesi Ledi Bianku ka paraqitur kundërrekurs. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të asaj gjykate, rekursi rezulton të jetë regjistruar në datën 10.11.2017, me nr. 31003-03330-00-

2017 dhe përveç caktimit të gjyqtarit relator, nuk rezulton të jetë kryer ndonjë veprim tjetër në lidhje me këtë çështje.

4. Me kërkesën nr. 286 prot., datë 28.1.2021, të dy kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes administrative ku janë palë, duke pretenduar se vonesa prej më shumë se 3 vjetësh u ka shkaktuar një dëm të paarsyeshëm, pasi i ka dhënë palës së paditur mundësinë të justifikojë mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore me arsyetimin se çështja është për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, si dhe u ka cenuar të drejtën për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm.

5. Me shkresën nr. 286/1 prot., datë 1.2.2021, kancelari i Gjykatës së Lartë u ka kthyer përgjigje kërkuesve se në bazë të nenit 474 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), kërkesa duhet të nënshkruhet nga avokati që përfaqëson palën, ndaj u kthehet pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse në këtë drejtim.

6. Me kërkesën e datës 21.4.2021, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

7. Me vendimin e datës 21.5.2021, Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 28.6.2021, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

8. Në cilësinë e ndërhyrësit dytësor, referuar nenit 191 të KPC-së, shtetasi Bardhyl Ibra i është drejtuar Gjykatës me kërkesën e datës 22.9.2021, të regjistruar me nr. 1 (L)/II 2021, datë 29.9.2021, duke pretenduar se ky proces është me rëndësi për të. Me shkresën nr. 1 (L) 2021, datë 5.10.2021, këtij shtetasi i është kërkuar të paraqesë argumente në mbështetje të kërkesës për ndërhyrjen e tij në proces.

9. Gjykata, pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë paraprake, me vendimin e ndërmjetëm të datës 28.10.2021, vendosi rrëzimin e saj si të pabazuar. Sipas nenit 39 të ligjit nr. 8577/2000, pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë: a) subjekti që ka paraqitur kërkesën ose përfaqësuesi i tij; b) subjektet kundër të cilave është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet; c) organi që ka nxjerrë aktin; ç) organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje për kompetencë. Vlerësimi i legjitimimit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interes të subjektit, por edhe të gjykimit kushtetues dhe, në këtë kuptim, në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato që, për shkak të veprimtarisë ose rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuesit ose dhe kryesisht nga Gjykata (*shih vendimet nr. 9, datë 23.3.2010; nr. 29, datë 21.10.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerësoi se shtetasi Bardhyl Ibra nuk arriti të argumentojë interesin e tij në këtë çështje.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesit*** pretendojnë se iu është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto elemente:

10.1 *E drejta e aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj* për shkak të kthimit pa veprime të kërkesës për përshpejtimin e procedurave nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë. Në çështjen konkrete nuk ka pasur shqyrtim dhe vendim nga një gjyqtar, në kuptim të nenit 57 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (*ligji nr. 49/2012*). Edhe bazuar në nenin 154/a, pika 3, të KPC-së, kthimi i kërkesës pa veprime bëhet nga gjyqtari i vetëm, procedurë që gjen zbatim edhe në Gjykatën e Lartë. Formulimi në nenin 399/5 të KPC-së, duke përdorur termin "nëse", tregon se kërkesa mund të bëhet edhe nga vetë kërkuesi, por nëse bëhet nga avokati kërkohet prokurë. Një parashikim i tillë për detyrimin e firmës nga një avokat, në rastin kur vetë ankuesi është jurist/avokat, është joproporcional për qëllimet e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së.

10.2 *Mungesa e mjetit efektiv për përshpejtim procedurash*, në kushtet kur kërkesa fillestare për kohëzgjatje procedurash është regjistruar në Gjykatën e Lartë më 10.11.2017 dhe prej më shumë

se 3 vjetësh nuk ka ende një vendimmarrje prej saj. Kjo vonesë u ka shkaktuar kërkuesve një dëm të paarsyeshëm, pasi i ka dhënë mundësinë palës së paditur të justifikojë mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit.

10.3 *Mosshqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm, në veçanti në Gjykatën e Lartë*. Në nenin 399/2 të KPC-së është përcaktuar afati 1-vjeçar si i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve në shkallë të parë dhe në apel. Ndonëse dispozita nuk ka parashikuar afat specifik për çështjet administrative që gjykohen në Gjykatën e Lartë, kjo mungesë parashikimi nuk e bën të pazbatueshme procedurën e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, pasi në këtë rast gjen zbatim afati i përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 10.11.2017 dhe deri në paraqitjen e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm kanë kaluar 3 vjet e 4 muaj dhe nuk është ndërmarrë asnjë hap procedural nga ajo gjykatë, përveç caktimit të gjyqtarit relator. Në kohëzgjatjen përtej afatit të arsyeshëm nuk ka ndikuar asnjë prej rrethanave të parashikuara në nenin 399/2 të KPC-së dhe nuk përbën shkak justifikues as reforma në drejtësi, as procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve, qëndrim i mbajtur edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*).

10.4 Kërkesa për shterimin e mjeteve juridike nuk mund të zbatohet në rastet kur mjeti që duhet shteruar nuk është efektiv. Efektiviteti në lidhje me këto çështje kërkon një vendim që konstaton shkeljen, urdhëron pagesën e dëmit për vonesën e shkaktuar, si dhe përshpejtimin e vendimmarrjes mbi themelin. Pavarësisht përmbajtjes së nenit 399/6, pika 3, të KPC-së, mosakordimi i një dëmshpërblimi në procedurat para Gjykatës rrezikon të çojë në përfundimin se ajo nuk është mjet efektiv për qëllimet e nenit 13 të KEDNJ-së të interpretuar me nenin 6, pika 1, të saj.

10.5 Gjykata e Lartë nuk e ka objektivisht të mundur që proceduralisht të zgjidhë ankesën për shkeljen e kohëzgjatjes dhe ndreqjen e pasojave në kohë. Në momentin e paraqitjes së kërkesës për përshpejtim në Gjykatën e Lartë ajo kishte në përbërje vetëm një kolegj, i cili ishte vetë në vonesë në shqyrtimin e çështjes së themelit. Fakti që me zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj mund të krijohet një kolegj i ri në Gjykatën e Lartë për të shqyrtuar vonesat në shqyrtimin e çështjeve, nuk e ndryshon thelbin e ankesës, pasi efektiviteti i një mjeti vlerësohet në momentin e vënies në lëvizje të tij.

10.6 Veprimet e kryera nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (*ASHK*), nuk cenojnë thelbin e kërkesës, pasi kërkuesit janë ankuar edhe për kohëzgjatjen në mosekzekutimin e vendimit nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, i cili është një pretendim i pavarur nga ai i kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit. Kjo çështje nuk shfaq kompleksitet dhe nuk ka pasur asnjë lloj vështirësie që të krijonte vonesa në ekzekutimin e vendimit.

11. ***Subjekti i interesuar, ASHK-ja,*** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim para Gjykatës.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

12. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

13. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata vëren se kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, pasi kanë

qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë, ndaj provojnë interesin e drejtpërdrejtë në këtë çështje.

15. Një kriter tjetër paraprak, që duhet të përmbushet nga individi përpara se t'i drejtohet Gjykatës, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000.

16. Sipas këtij kriteri kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili, para se t'i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata ka vlerësuar se mjeti juridik përshpejtues është "efektiv" nëse përshpejton vendimmarrjen e gjykatës në fjalë. Ajo, gjithashtu, ka theksuar rëndësinë e parimit të subsidiaritetit, sipas të cilit, përpara se t'i drejtohen kësaj Gjykate, individët duhet të shfrytëzojnë mjetet që ofron sistemi juridik. Prandaj, aty ku legjislacioni ka parashikuar një mjet juridik, Gjykata do të vlerësojë nëse ky mjet është ose jo efektiv (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuesit i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe nëse ato kanë qenë efektive për të garantuar të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë këndvështrim, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e tyre për mungesën e mjetit efektiv të përshpejtimit të procedurave, që ata e kanë ngritur në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, si dhe për cenimin e aksesit dhe të gjykatës së caktuar me ligj nga veprimet administrative të kancelarit të Gjykatës së Lartë.

19. Gjykata vëren, gjithashtu, se në jurisprudencën e saj e ka legjitimuar individin për paraqitjen e kërkesave me objekt mosgjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, edhe kur për to nuk ishte dhënë një vendim përfundimtar, ose mosekzekutimin e vendimit brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, edhe kur legjislacioni nuk parashikonte mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 12 datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Me ligjin nr. 38/2017, "Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile", në KPC u shtuan dispozita të reja për afatet e arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, nenet 399/1–399/12. Me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve në datën 5.11.2017, Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni vendas parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore *(shih vendimin nr. 80, datë 18.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Gjykata rithekson se mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së në parim janë efektive. Për sa i takon efektivitetit të tyre në praktikë, Gjykata, në këndvështrim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, vlerëson se duhen shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret. Në këtë aspekt, ajo mban në konsideratë edhe faktin se për zbatimin e mjeteve juridike të parashikuara nga KPC-ja për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, nuk ka ende një qëndrim të konsoliduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se janë mjete relativisht të reja (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Përveç sa më sipër, Gjykata thekson se gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të dispozitave procedurale dhe shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim, duhet të shmangin formalizmat e tepruar dhe t'i shqyrtojnë këto lloj kërkesash me përparësi, përndryshe ky mjet juridik do të humbiste qëllimin për të cilin është miratuar nga ligjvënësi. Në këtë aspekt, gjykatat, në shqyrtimin e këtyre kërkesave, duhet të kenë parasysh kritere të tilla, si: lloji i së drejtës objekt kërkimi dhe natyra e çështjes së themelit për të cilën kërkohet përshpejtimi, dëmi i mundshëm që mund t'i vijë kërkuesit, kohëzgjatja e çështjes në shkallë të zakonshme të gjykimit, organizimi i

brendshëm i punës në gjykatë, si dhe çdo kriter i rëndësishëm, me qëllim që të mos cenohet thelbi i së drejtës (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi i gjykatës së apelit është kundërshtuar në Gjykatën e Lartë nga pala e paditur në procesin gjyqësor (subjekti i interesuar) dhe ndaj tij ka paraqitur kundërrekurs edhe kërkuesi Ledi Bianku. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të asaj gjykate, kjo çështje është regjistruar në datën 10.11.2017, me nr. 31003-03330-00-2017 dhe deri në datën e gjykimit të kësaj çështjeje, përveç caktimit të gjyqtarit relator, nuk rezulton të jetë kryer ndonjë veprim tjetër.

24. Me kërkesën nr. 286 prot., datë 28.1.2021, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes administrative ku janë palë. Sipas tyre, vonesa prej më shumë se 3-vjeçare u ka shkaktuar një dëm të paarsyeshëm, pasi i ka dhënë palës së paditur mundësinë të justifikojë mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore me arsyetimin se çështja është për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, si dhe u ka cenuar të drejtën për proces të rregullt, si pasojë e mosshqyrtimit të saj brenda një afati të arsyeshëm. Me shkresën nr. 286/1 prot., datë 1.2.2021 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, kërkuesve u është kthyer përgjigje se në bazë të nenit 474 të KPC-së kërkesa duhet të jetë nënshkruar nga avokati që përfaqëson palën, ndaj ajo u kthehet pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse në këtë drejtim. Në vijim, kërkuesit i janë drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese me kërkesën e datës 21.4.2021, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar pretendimet e pasqyruara më sipër në vendim.

25. Gjykata vëren se në kuptim të nenit 399/3, pika 2, të KPC-së, të drejtën për të kërkuar shpërblimin e drejtë për shkak të shkeljes së afatit të arsyeshëm e ka cilido që është i përfshirë në një proces ligjor në cilësinë e palës. Sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja "c", kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave në Gjykatën e Lartë, i drejtohet po asaj gjykate dhe shqyrtohet nga një kolegj tjetër, në dhomë këshillimi, brenda 45 ditëve nga paraqitja e saj (neni 399/7, pika 2).

26. Kancelari i Gjykatës së Lartë në shkresën e tij nr. 286/1 prot., datë 1.2.2021 i është referuar nenit 474 të KPC-së, që përcakton kriteret formale që duhet të plotësojë rekursi, çka nuk është rasti në shqyrtim, dhe jo nenit 399/5, pika 2, shkronja "ç", të KPC-së që parashikon: "*Bashkë me kërkesën duhet të depozitohen edhe: ç) prokura, nëse kërkesa është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit.*".

27. Gjykata rithekson se veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës) (*shih vendimet nr. 68, datë 17.11.2015; nr. 48, datë 29.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë ka detyrimin të sillet në atë mënyrë që kërkesa për përshpejtim të mos humbasë qëllimin e vet dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se qasja, sipas së cilës një kërkuesi me profesion avokat i kërkohet nënshkrimi i rekursit nga një mbrojtës, me pasojë mospranimin e tij, është formaliste dhe përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, në këndvështrim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (*shih Dyluś kundër Polonisë, 23 shtator 2021 § 45*).

29. Gjykata evidenton se njëri prej kërkuesve, Ledi Bianku, ka qenë pedagog efektiv i lëndëve juridike në Fakultetin e Drejtësisë, si dhe ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në GJEDNJ për periudhën 2008-2019, funksione të cilat, sipas legjislacionit të kohës, përjashtoheshin, për shkak të cilësive profesionale, nga plotësimi i kritereve dhe kushteve të nevojshme për fitimin e titullit të avokatit dhe vetëm për këtë shkak konsideroheshin nga ligjvënësi si raste të veçanta për t'u pajisur me këtë titull.

30. Gjykata konstaton se në rastin në shqyrtim jo vetëm që nuk jemi para rastit të paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, por të një kërkese për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit dhe përshpejtimin e procedurave, por edhe se kërkesa është paraqitur nga vetë kërkuesi në cilësinë e tij si avokat dhe ish-gjyqtar në GJEDNJ. Në kuptim të sa më sipër, kërkesa e paraqitur në Gjykatën e Lartë është kthyer pa veprime nga ana e kancelarit, çka ka sjellë mosregjistrimin e saj. Kjo ka bërë që kërkuesit të mos merrnin përgjigje edhe për përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tyre në atë gjykatë, duke mos pasur as një vendim përfundimtar në lidhje

me këtë kërkesë. Për rrjedhojë, interpretimi i bërë nga kancelari i Gjykatës së Lartë shkon përtej përmbajtjes dhe frymës së nenit 399/5, pika 2, shkronja "ç", të KPC-së dhe përbën një formalizëm të tepruar. Në këtë mënyrë, nga një rregull garantues procedural, ai është kthyer në një mjet pengues të aksesit në Gjykatën e Lartë. Për shkak të këtyre rrethanave, Gjykata vlerëson se në rastin konkret kërkuesit janë shkarkuar nga detyrimi për të shteruar këtë mjet juridik përpara paraqitjes së ankimit kushtetues.

31. Kërkuesit kanë kërkuar edhe konstatimin e cenimit lidhur me kohëzgjatjen në ekzekutimin e vendimit nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Kërkuesit kanë parashtruar se kanë vënë në lëvizje procedurat për përfundimin e regjistrimit të pronës së paluajtshme në pronësinë e tyre. Megjithatë, sipas kërkuesve, lëshimi i urdhrit të ASHK-së për ekzekutimin e vendimit nuk cenon thelbin e pretendimit për kohëzgjatjen e procedurave në ekzekutim, i cili është një pretendim i pavarur nga ai i kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk i kanë shteruar mjetet e ankimit, pasi jo vetëm që nuk kanë përdorur mjetet procedurale që ofron legjislacioni për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë, por ata nuk arritën as të provojnë se iu është cenuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës me kërkesë për përshpejtimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

32. Kërkuesit, gjithashtu, kanë kërkuar urdhërimin e gjykatës së shkallës së parë, në përputhje me nenet 399/6, pika 1, shkronja "ç" dhe 399/10 të KPC-së, për shpërblimin e dëmit për vonesën në gjykimin në Gjykatën e Lartë, në veçanti, dhe ekzekutimin e vendimit në 6 vjet e 3 muaj vonesë, në përgjithësi. Po sipas tyre, mosakordimi i një dëmshpërblimi në procedurat para Gjykatës Kushtetuese, rrezikon të çojë në përfundimin se ajo nuk është një mjet efektiv. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, vlerëson se ato nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

33. Në lidhje me kriterin tjetër, atë të respektimit të afatit të paraqitjes së kërkesës, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vëren se në kushtet e një shkeljeje që vazhdon të ekzistojë, pavarësisht se nuk ka vendim përfundimtar për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, kërkuesit i lind e drejta t'i drejtohet Gjykatës në çdo kohë përgjatë periudhës që shkelja vazhdon. Në rastin konkret afati është tejkaluar dhe, në këtë kuptim, kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

34. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, në kërkesën e tyre kërkuesit janë shprehur se: "*Po ju le në vlerësimin tuaj që të vlerësoni apo jo procesin e ngritjes së Gjykatës Kushtetuese në përputhje me ligjin.*". Gjykata vlerëson se në vështrim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, në kushtet kur kërkuesit nuk kanë sjellë argumente ose dokumente për të mbështetur këtë parashtrim, ai nuk plotëson kushtet që të merret në shqyrtim prej saj. Ndërsa, për sa i përket pretendimit për kohëzgjatjen e paarsyeshme të shqyrtimit të rekursit, Gjykata vlerëson se ai përben objekt vlerësimi për kontrollin kushtetues.

B. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

35. Kërkuesit pretendojnë cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë, në kundërshtim me nenin 60, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 10.11.2017 dhe deri në paraqitjen e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm kanë kaluar 3 vjet e 4 muaj dhe asnjë hap procedural nuk është ndërmarrë nga Gjykata e Lartë, përveç caktimit të gjyqtarit relator. Sipas tyre, në kohëzgjatjen përtej afatit të arsyeshëm nuk ka ndikuar asnjë prej rrethanave të parashikuara në nenin 399/2 të KPC-së dhe nuk përbën shkak justifikues as reforma në drejtësi ose procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve, qëndrim i mbajtur edhe nga GJEDNJ-ja.

36. Sipas nenit 42 të Kushtetutës kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

37. Sipas jurisprudencës kushtetuese, e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e së cilës është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut *(shih vendimin nr. 18, datë 19.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese)*. Kjo dispozitë

vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme *(shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 22 datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese)*.

38. Gjykata lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuesit dhe rrezikun që passjell për të kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit, kompleksitetin e çështjes, si dhe sjelljen e autoriteteve *(shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

39. Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e procesit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor, deri në momentin kur jepet vendimi *(shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*.

40. Lidhur me periudhën *që duhet marrë në konsideratë*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhen me kohëzgjatjen e procesit në Gjykatën e Lartë, e cila nuk ka marrë ende në shqyrtim rekursin dhe kundërrekursin e paraqitur nga palët ndërgjyqëse, çka, sipas tyre, ka sjellë pasoja edhe në kohëzgjatjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës së apelit.

41. Me ndryshimet e vitit 2017, KPC-ja, në nenin 399/2 ka përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme dhe lidhur me gjykimet administrative, kjo dispozitë nuk ka parashikuar afate për gjykimin në Gjykatën e Lartë, por vetëm për gjykimin administrativ në shkallë të parë dhe në apel. Nga ana tjetër, ligji nr. 49/2012, në nenin 60, pika 2, të tij, parashikon se Gjykata e Lartë shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi.

42. Gjykata vëren se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i datës 14.4.2016, kurse ai i gjykatës së apelit i datës 13.3.2017. Në bazë të rekursit dhe kundërrekursit të paraqitur nga palët ndërgjyqëse, kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 10.11.2017 dhe deri në momentin e vendimmarrjes së Gjykatës për këtë çështje ajo nuk është shqyrtuar ende, edhe pse kanë kaluar mbi 3 vjet nga regjistrimi i saj.

43. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se *prima facie* në rastin konkret ka një tejzgjatje të procedurave gjyqësore. Në këtë kontekst, për të arritur në konkluzionin nëse jemi përpara cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duhet të analizojë elementet e tjera, për vijon më poshtë.

ii. Sjellja/interesi për kërkuesit dhe rreziku nga tejzgjatja e procedurave

44. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse ai është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim *(shih vendimet nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese)*.

45. Sipas GJEDNJ-së, sjellja e kërkuesve përbën një faktor objektiv që duhet të merret parasysh për vlerësimin nëse është tejkaluar koha e arsyeshme, sipas kërkesave të nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së *(shih Humen kundër Polonisë [GC], 15 tetor 1999, § 66)*. Disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm gjykimi në procedurat vendase. Në këto raste, duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor. Prandaj është thelbësore të trajtohen me shpejtësi të veçantë çështjet që kanë të bëjnë me kujdestarinë (*shih Tsikakis kundër Gjermanisë, 10 shkurt 2011, §§ 64 dhe 68; Nuutinen kundër Finlandës, 27 qershor 2000, § 110)*, punësimin (*shih Thlimmenos kundër Greqisë [GC], 6 prill 2000, §§ 60 dhe 62)*, "sëmundjet e pashërueshme dhe jetëgjatësinë e shkurtër" *(A. dhe të tjerët kundër Danimarkës, 8 shkurt 1996, §§ 78–81; X kundër Francës, 31 mars 1992, § 47)*.

46. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesit kanë vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në

këtë drejtim. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuesit dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për ta, Gjykata vëren se në kuptim të dispozitave procedurale të KPC-së, e drejta për shpërblim për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes lind për secilën palë në proces që provon ardhjen e dëmit pasuror ose jopasuror, pra provon se është viktimë e shkeljes së të drejtave kushtetuese. Siç rezulton nga aktet bashkëlidhur kërkesës, me vendimin nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur: "*Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Shfuqizimin e shkresës nr. 925/6 prot., datë 25.8.2015, të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimore Informale, Drejtoria Tirana 4. Detyrimin e palës së paditur ALUIZNI-t që të përmbyllë procedurat për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin mbi parcelën ndërtimore në lidhje me shtetasit Ledi Bianku dhe Odeta Kumbaro, sipas kontratës nr. 2017 rep., nr. 690 kol., datë 6.3.2012. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të padisë.*". Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 998 (86-2016-965), datë 13.3.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas akteve të dosjes gjyqësore të administruara nga Gjykata për qëllime të këtij procesi, kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë pala e paditur në procesin gjyqësor, ALUIZNI dhe kundërrekurs vetëm kërkuesi Ledi Bianku.

47. Fillimisht, Gjykata thekson se pretendimi për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë është paraqitur si pretendim më vete nga kërkuesit dhe ai është trajtuar më sipër (*shih paragrafin 31 të vendimit*). Gjykata vëren se, në përputhje me parashikimet e neneve 449 dhe 451 të KPC-së, vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe paraqitja e rekursit në Gjykatën e Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar, në bazë të nenit 479 të KPC-së. Më tej KPC-ja ka parashikuar rregullat dhe procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë. Sipas nenit 510 të KPC-së janë tituj ekzekutivë vendimet civile të formës së prerë të gjykatës që përmbajnë një detyrim, të cilët vihen në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit (neni 511 i KPC-së). Kodi ka parashikuar edhe procedurat e ekzekutimit dhe mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve.

48. Gjykata vëren se në parashtrimet e tyre kërkuesit janë shprehur se në gusht të vitit 2021 i janë drejtuar një përmbaruesi gjyqësor privat, me qëllim që paralelisht të ndjekin ekzekutimin e vendimit gjyqësor që ishte bërë i ekzekutueshëm. Përmbaruesi, me shkresën e datës 25.8.2021, i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të vendimit të formës së prerë dhe, sipas kërkuesve, ASHK-ja është përgjigjur me letrën e datës 7.9.2021 se vendimi është ekzekutuar me urdhrin nr. 11, datë 6.7.2019 dhe se në datën 8.7.2019 praktika i është përcjellë Drejtorisë Vendore të ASHK-së Kavajë. Ky institucion ka njoftuar përmbaruesin se në datën 3.9.2021 ka kryer edhe një mandatpagesë për shpenzimet gjyqësore në favor të palës kreditore pranë bankës "Credins Bank".

49. Gjykata, bazuar në aktet e paraqitura nga kërkuesit bashkëlidhur parashtrimeve të tyre, konstaton se ASHK-ja ka miratuar lejen e legalizimit nr. 704776, datë 7.6.2019 për objektin "banim" në favor të kërkuesve Ledi Bianku dhe Odeta Kumbaro, sipas të dhënave të kësaj pasurie, bazuar në genplanin dhe planimetrinë bashkëlidhur këtij akti. Me shkresën nr. 2004 prot., datë 22.5.2020, ASHK-ja u ka dërguar kërkuesve këto akte, të cilat u janë ridërguar nga ky institucion me shkresën nr. 2004/1 prot., datë 7.9.2021, sipas së cilës rezulton se dokumentacioni është përcjellë për regjistrim edhe në Drejtorinë Vendore të ASHK-së Kavajë.

50. Për sa më sipër, gjatë gjykimit rezultoi se ASHK-ja ka nxjerrë lejen e legalizimit në vitin 2019, e cila, sipas akteve dhe parashtrimeve të paraqitura nga vetë kërkuesit (në mungesë të parashtrimeve nga ASHK-ja), u është njoftuar atyre me postë në vitin 2021. Kërkuesit janë pajisur me një vendim të formës së prerë në favorin e tyre, për të cilin jo vetëm që nuk ka pasur një vendim pezullimi për ekzekutimin e tij, por në momentin e paraqitjes së kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në Gjykatën e Lartë (28.1.2021), institucioni debitor kishte vepruar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ky vendim, pa pasur nevojën për vënien në lëvizje të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm nga kërkuesit si palë kreditore.

51. Po ashtu, Gjykata thekson se të njëjtat parashtrime dhe aktet e sipërcituara të paraqitura në këtë gjykim, kërkuesit nuk kishin pengesë që t'i paraqisnin edhe në Gjykatën e Lartë, në mënyrë që t'i jepnin mundësinë kësaj të fundit të vlerësonte këto rrethana, me qëllim

përshpejtimin e gjykimit të kësaj çështjeje. Pavarësisht sa më sipër, në kushtet aktuale Gjykata e Lartë nuk ka arsye pse të mos e marrë në shqyrtim me përparësi çështjen e kërkuesve.

52. Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkuesve nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme, për shkak se ajo nuk ka sjellë pasoja thelbësore në ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

53. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesit me sjelljen e tyre nuk janë bërë shkak për vonesa, megjithatë, nga pikëpamja e interesit, në kushtet kur ata janë pajisur me një vendim të formës së prerë, ekzekutimi i të cilit nuk është pezulluar nga gjykatat, por është lëshuar leja e legalizimit dhe ka vijuar procedura për regjistrimin e pronës, arrihet në përfundimin se ata nuk ndodhen përballë ndonjë shkalle të konsiderueshme rreziku.

iii. Kompleksiteti i çështjes

54. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme *(shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Sipas GJEDNJ-së, kompleksiteti i çështjes mund të lidhet si me faktet, ashtu edhe me ligjin *(shih Papachelas kundër Greqisë[GC], 25 mars 1999, § 39; Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë, 27 tetor 1994, § 55)*, me përfshirjen e disa palëve në proces *(shih H. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 korrik 1987, § 72)* ose me prova të ndryshme që duhet të merren *(shih Humen kundër Polonisë [GC], 15 tetor 1999, § 63)*.

56. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, që rregullohet nga ligji nr. 49/2012 dhe ka për objekt detyrimin e organit të administratës publike, ASHK-ja, ish-ALUIZNI, të ndryshojë pjesërisht aktin administrativ të nxjerrë prej tij, si dhe të përfundojë procedurat e legalizimit për pasurinë objekt gjykimi deri në dërgimin e dosjes për regjistrim përfundimtar në ZVRPP.

57. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në gjykim, Gjykata vlerëson se kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë vonesë në shqyrtimin e saj, për më tepër në kushtet kur, siç pranohet edhe nga vetë kërkuesit, është lëshuar leja e legalizimit nr. 704776, datë 7.6.2019 në favor të tyre.

iv. Sjellja e autoriteteve

58. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimin nr. 22, datë 29.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e çështjeve brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht *(shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 3, datë 6.12.2018; nr. 26, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Gjykata vëren se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 ka përcaktuar, ndër parimet e gjykimit administrativ, edhe sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative, çka rezulton edhe nga relacioni bashkëlidhur këtij ligji, sipas të cilit ai synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, si dhe garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjykata vëren, gjithashtu, se ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate konkrete për gjykimin në të tria shkallët e gjykimit. Gjykata ka vlerësuar se, përderisa ligjvënësi ka vendosur afate kohore të caktuara do të thotë se ai i ka konsideruar ato jo vetëm si afate të arsyeshme, por edhe të detyrueshme për zbatim nga gjykatat administrative të të gjitha shkallëve të gjykimit. Pengesat e mundshme

objektive duhet të gjejnë zgjidhje nëpërmjet rregullimit që duhet të bëjë ligjvënësi (*shih vendimet nr. 3, datë 6.2.2018; nr. 22, datë 20.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, Gjykata vlerëson të tregojë një qasje më të kujdesshme, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave të tilla në një mënyrë që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës, për të zgjidhur një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e këtij lloji rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme *(shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka marrë hapa konkretë, duke parashikuar një sërë masash me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura brenda një kohe sa më të shpejtë, si: rritja e kapaciteteve njerëzore, inventarizimi i çështjeve, përpunimi deri në shqyrtimin e tyre, përgatitja e planeve të veprimit, me qëllim shqyrtimin e çështjeve sipas kronologjisë kohore dhe specifikës së çështjes. Gjithsesi, edhe në këtë rast Gjykata rithekson se masat e marra nga autoritetet shqiptare nuk janë të mjaftueshme, përderisa procedurat në Gjykatën e Lartë po zgjasin tej afateve të arsyeshme *(shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Pavarësisht kësaj, kjo rrethanë nuk ndikon në çështjen konkrete në shqyrtim, për sa kohë që Gjykata vlerësoi mungesën e interesit të kërkuesve dhe të rrezikut që passjell për ta kohëzgjatja e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën Lartë.

62. Në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve, Gjykata vlerëson të rëndësishme të ndalet në sjelljen e institucionit tjetër të përfshirë në këtë proces, ASHK-ja, që është edhe pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me anë të rekursit kundër vendimit të gjykatës së apelit.

63. Siç u theksua më sipër, gjatë gjykimit u konstatua se ASHK-ja ka lëshuar lejen e legalizimit, çka ka qenë edhe objekti i mosmarrëveshjes në gjykim. Me shkresën nr. 2004 prot., datë 22.5.2020 ASHK-ja u ka dërguar kërkuesve lejen e legalizimit, shoqëruar me genplanin dhe planimetrinë, dhe këto akte u janë ridërguar atyre me shkresën nr. 2004/1 prot., datë 7.9.2021, për shkak të kthimit nga posta në datën 1.6.2020 të shkresës së datës 22.5.2020. Megjithatë, Gjykata vlerëson të theksojë se njoftimi i lejes së legalizimit dhe i akteve shoqëruese pas më shumë se 1 viti nga kthimi i tyre nga posta konsiderohet e parregullt dhe organi shtetëror nuk ka vepruar në përputhje me detyrimet e tij, duke mos respektuar të drejtat e palës në procedurën administrative, në rastin konkret të drejtën për t'u njoftuar.

64. Në përfundim, në rastin konkret, edhe pse duket se deri diku ka një tejzgjatje të procesit dhe se sjellja e kërkuesve nuk ka penguar ecurinë e tij, si dhe për faktin se masat e marra nga autoritetet janë të pamjaftueshme, Gjykata, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, sidomos rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkuesve, si dhe numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë, në pritje për t'u gjykuar nga një numër i reduktuar gjyqtarësh, vlerëson se nuk ka cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 71/a, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 5.11.2021.
Shpallur më 1.12.2021.

Kryetare: Vitore Tusha
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Altin Binaj

MENDIM PARALEL

1. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me shumicën për rrëzimin e kërkesës, kam mendim të ndryshëm për sa u takon shkaqeve për këtë qëndrim, pasi vlerësoj se kërkesa duhej rrëzuar për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike efektive për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

2. Neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës parashikon se "Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar *të gjitha mjetet juridike efektive* për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë".

3. Në drejtim të renditjes së standardeve jurisprudenciale, të vendosura nga kjo Gjykatë, lidhur me kriterin e shterimit të mjetit juridik efektiv *(shih paragrafët 15–17, si dhe 19–20 të vendimit)*, jam dakord me shumicën, por kam qëndrim të ndryshëm për sa i përket mënyrës se si ajo i ka zbatuar këto standarde, në rastin konkret për të gjitha kërkimet e kërkuesve sipas objektit të kërkesës.

4. Fillimisht theksoj se për konstatimin e shkeljes së procesit të rregullt për sa i përket kohëzgjatjes në ekzekutimin e vendimit nr. 1800 (1802), datë 14.4.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shumica e ka analizuar duke arritur në përfundimin se kërkuesit nuk i kanë shteruar mjetet e ankimit *(shih paragrafin 31 të vendimit)*, qëndrim të cilit i bashkohem edhe unë.

5. Ndërkohë, shumica i ka legjitimuar kërkuesit lidhur me shterimin e mjetit juridik për tejzgjatjen e procesit në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, sipas saj, "...Për shkak të këtyre rrethanave, Gjykata vlerëson se në rastin konkret kërkuesit janë shkarkuar nga detyrimi për të shteruar këtë mjet juridik përpara paraqitjes së ankimit kushtetues *(shih paragrafin 30 të vendimit*). Po ashtu, shumica ka analizuar pretendimin e cenimit të aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj dhe konstatimin e mungesës së mjetit efektiv për përshpejtimin e rekursit në kuadër të shterimit të mjetit juridik efektiv për konstatimin e tejzgjatjes së procesit në Gjykatën e Lartë *(shih paragrafët 18 dhe 30 të vendimit)*. Pra, ajo e ka parë pretendimin e cenimit të aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj së bashku, me pretendimin për mungesën e mjetit efektiv, për të cilin unë mendoj se duhej trajtuar më vete.

6. Në vlerësimin tim, në rastin konkret kërkuesit nuk kanë qenë në rrethana të tilla që të shkarkoheshin nga detyrimi për të shteruar *mjetet juridike efektive* në dispozicion, për të gjitha pretendimet me argumentet për sa vijon.

A. Për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj

7. Bazuar në nenin 399/5 të KPC-së, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes administrative ku janë palë. Me shkresën nr. 286/1 prot., datë 1.2.2021, të kancelarit të Gjykatës së Lartë, kërkuesve u është kthyer përgjigje se në bazë të nenit 474 të KPC-së, kërkesa duhet të jetë e nënshkruar nga avokati që përfaqëson palën, ndaj ajo u kthehet pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse në këtë drejtim. Edhe pse në rastin konkret kërkesa për konstatimin e

shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, e nënshkruar nga vetë kërkuesit, është kthyer pa veprime nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë për t'u plotësuar me nënshkrimin e avokatit, nuk rezulton që kërkuesit të kenë paraqitur një kërkesë të re të plotësuar.

8. Sipas kërkuesve, është cenuar e drejta e aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj, për shkak të kthimit pa veprime të kërkesës për përshpejtimin e procedurave nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë. Në çështjen konkrete nuk ka pasur shqyrtim dhe vendim nga një gjyqtar, në kuptim të nenit 57 të ligjit nr. 49/2012. Bazuar edhe në nenin 154/a, pika 3, të KPC-së kthimi i kërkesës pa veprime bëhet nga gjyqtari i vetëm, procedurë që gjen zbatim edhe në Gjykatën e Lartë. Formulimi në nenin 399/5 të KPC-së, duke përdorur termin "nëse", tregon se kërkesa mund të bëhet edhe nga vetë kërkuesi, por nëse bëhet nga avokati kërkohet prokurë. Interpretimi në themel i kancelarit të Gjykatës së Lartë është *contra legem* i nenit 399/5 të KPC-së, që, për më tepër, është edhe *lex specialis* për procedurat në fjalë. Edhe nëse ky do të ishte rasti sipas legjislacionit të brendshëm, siç pretendon gabimisht kancelari i Gjykatës së Lartë, një parashikim i tillë për detyrimin e firmës nga një avokat në rast kur vetë kërkuesi është jurist/avokat, është joproporcional për qëllimet e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për sa i përket aksesit në gjykatë. Edhe nga GJEDNJ-ja në çështjen *Dyluś kundër Polonisë*, vendim i datës 23.9.2021 *(footnote 3 e parashtrimeve të kërkuesve*), është konstatuar shkelje e nenit 6 të KEDNJ-së, në këndvështrim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës.

9. Shumica, duke e pranuar si formalizëm të tepruar interpretimin e nenit 399/5, pika 2, shkronja "ç", të KPC-së nga ana e kancelarit me shkresën e sipërcituar, mbështetur dhe në qëndrimin e GJEDNJ-së në vendimin *Dylus*, ka renditur tri arsye për argumentimin: (i) në rastin konkret nuk jemi para rastit të paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, por të një kërkese për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit dhe përshpejtimin e procedurave; (ii) profili i njërit prej kërkuesve, Ledi Bianku *(L.B.)*, si ish-gjyqtar në GJEDNJ; (iii) cilësitë e kërkuesit L.B. si avokat *(shih paragrafët 29 dhe 30 të vendimit*).

10. Në vlerësimin tim, pretendimi për shkeljen e aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj është i pavarur dhe autonom, ashtu sikundër e kanë parashtruar edhe kërkuesit. Thelbi i shkeljes së këtij parimi, të procesit të rregullt ligjor, sipas kërkuesve, qëndron tek shkresa e kancelarit të Gjykatës së Lartë, ndaj edhe shumica duhej të kishte analizuar nëse ishte plotësuar kriteri i shterimit të mjetit efektiv ligjor në këtë kontekst. Ky pretendim qartësisht nuk është i lidhur me konstatimin e mungesës së mjetit efektiv për përshpejtimin e procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë, sikundër shumica e ka trajtuar (*shih paragrafin 18 të vendimit*).

11. Në lidhje me të drejtën e aksesit, në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

12. Gjykata ka theksuar se kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese)*. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Ajo ka nënvizuar se termi "*gjykatë*" karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar për një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta

e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit *(shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 1, datë 19.1.2018, të Gjykatës Kushtetuese)*.

14. Nga ana tjetër, në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej saj vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm *(shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*.

15. Duke iu kthyer rastit konkret, vërehet se në datën 1.2.2021 kërkuesve u është kthyer përgjigje nga kancelari i Gjykatës së Lartë se në bazë të nenit 474 të KPC-së, kërkesa duhet të jetë e nënshkruar nga avokati që përfaqëson palën, ndaj kërkesa u kthehet pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse në këtë drejtim. Kërkuesit nuk e kanë riparaqitur kërkesën pranë Gjykatës së Lartë të plotësuar, por i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 21.4.2021.

16. Neni 399/5 i KPC-së parashikon se kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave depozitohet në sekretarinë e gjykatës që është në vonesë, si dhe elementet dhe dokumentet që duhet të përmbajë dhe shoqërojnë atë. Sipas pikës 2, shkronja "ç", të këtij neni parashikohet se "*bashkë me kërkesën duhet të depozitohen edhe: ... ç) prokura, nëse kërkesa është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit*".

17. Për sa më lart, ndodhur përpara këtyre rrethanave, ku kancelari ka bërë interpretim të normës ligjore të sipërcituar, bazuar në parimin e subsidiaritetit, do të duhej që fillimisht kërkuesit të shteronin ankimin administrativ ndaj shkresës së kancelarit, sipas nenit 37, shkronja "f", të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të sistemit të drejtësisë", ku parashikohet se "kryetari i Gjykatës verifikon ankesat, heton shkeljet disiplinore dhe propozon fillimin e procedimit disiplinor ndaj kancelarit". Po ashtu, ankimi gjyqësor në gjykatën administrative, për pretendimet e tyre për paligjshmërinë, por edhe antikushtetutshmërinë e shkresës administrative të kancelarit, do të ishte shkalla tjetër për shterimin e mjetit efektiv të ankimit, nëse kryetari i Gjykatës së Lartë nuk do t'u jepte zgjidhje pretendimeve të tyre, përmes kontrollit administrativ. Sikundër kjo Gjykatë ka theksuar, sipas parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, së pari, funksion i gjykatave të zakonshme *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 83, datë 26.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Për më tepër, edhe vetë kërkuesit pretendojnë se formulimi në nenin 399/5, pika 2, shkronja "ç", të KPC-së, duke përdorur termin "nëse", tregon se kërkesa mund të bëhet edhe nga ata, por nëse bëhet nga avokati, kërkohet prokurë. Prandaj, edhe sipas tyre, jemi para pretendimeve lidhur me paligjshmërinë e veprimtarisë administrative të një organi administrativ.

19. Për rrjedhojë, pretendimet për veprimet administrative të kancelarit të Gjykatës së Lartë, të ngritura në këndvështrim të së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj, janë të tilla, për nga natyra, që kërkuesit do te duhej të kishin shteruar mjetet efektive në dispozicion, para se të paraqisnin ankim kushtetues individual.

20. Në rastin konkret, nëse do të pranonim të kundërtën, pra mosshterimin e mjeteve të sistemit gjyqësor të zakonshëm, do të zgjerohej aksesi kushtetues i individëve, për çdo paligjshmëri veprimesh të autoriteteve administrative, çka nuk është qëllimi i kushtetutëbërësit, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Ashtu sikundër kjo Gjykatë ka theksuar, duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 29, datë 30.3.2017; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për më tepër, nga ana e shumicës ka disa pasaktësi në analizën e dokumenteve, si dhe të argumenteve të paraqitura, që çmoj t'i evidentoj:

21.1 S*ë pari,* rezulton e paprovuar përmes një dokumenti zyrtar qenia e ndonjërit prej kërkuesve në cilësinë e avokatit që e ushtron këtë profesion. Edhe pse kërkuesi L.B. pretendon

se është avokat, ai nuk i ka paraqitur Gjykatës asnjë dokument provues në këtë drejtim. Po ashtu, është e vërtetë se ekziston mundësia që kërkuesi ta ketë fituar këtë cilësi, por përderisa ai nuk i ka paraqitur Gjykatës një dokument provues, shumica nuk ka përse ta prezumojë kërkuesin si të tillë. Nga ana tjetër, edhe pasja e titullit "avokat" në vetvete nuk tregon se në momentin e paraqitjes së kërkesës për përshpejtim të procesit kërkuesi ka qenë avokat aktiv, pasi legjislacioni ka një sërë kriteresh për t'u plotësuar që të mund të ushtrohet profesioni i avokatit.

21.2 *Së dyti,* duket sikur një nga argumentet e shumicës bazohet edhe në profilin e kërkuesit L.B. si ish-gjyqtar në GJEDNJ *(shih paragrafin 29 të vendimit)*, ndërkohë që vetë kërkuesi nuk e ka paraqitur një argument të tillë. Në fakt, diskutimi në rastin konkret qëndron në interpretimin e nenit 399/5, shkronja "ç", të KPC-së nga kancelari i Gjykatës së Lartë. Unë bie dakord me shumicën për shqetësimin lidhur me ngushtimin e aksesit të individëve me interpretimin që i është dhënë nga kancelari nenit 399/5 të KPC-së, praktikë e ndeshur dhe te kërkues të tjerë para kësaj gjykate (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, në respektim të standardeve, vlerësoj se kërkuesit ose duhet të kundërshtonin shkresën e kancelarit në rrugë administrative dhe gjyqësore, ose duhet të ndiqnin orientimin për paraqitjen e kërkesës për përshpejtim të procesit përmes përfaqësuesit ligjor.

21.3 *Së treti,* shumica thekson standardet e Gjykatës, sipas të cilave veprimet ose mosveprimet e administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës), bazuar në vendimet nr. 68, datë 17.11.2015 dhe nr. 48, datë 29.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese *(shih paragrafin 27 të vendimit*). Të dyja vendimet e cituara nga shumica, si standard i kësaj Gjykate, janë përkatësisht në kontekstin e veprimeve të parregullta të administratës gjyqësore për sa u përket njoftimeve me shpallje për procesin gjyqësor nga Gjykata e Apelit Tiranë, si dhe mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, edhe pse ishte paraqitur brenda afatit ligjor. Duke çmuar se standardet e kësaj Gjykate duhen vënë në kontekstin e duhur të çështjes, përmes një analize konkrete vlerësoj se rrethanat e kësaj çështje nuk janë gabime procedurale të administratës, por një nga mënyrat e të kuptuarit dhe të interpretuarit të nenit 399/5, pika 2, shkronja "ç", të KPC-së nga kancelari, si interpretuesi i parë i normës në rastin konkret.

21.4 *Së katërti,* sipas shumicës ka pasur formalizëm të tepruar nga kancelari, në dëm të aksesit në gjykatë, mbështetur edhe në vendimin e GJEDNJ-së *Dylus kundër Polonisë (shih paragrafin 28 të vendimit*). Ndërkohë, konteksti i rrethanave në çështjen *Dylus* ka qenë ndryshe nga ai i kërkuesve që kanë iniciuar këtë proces kushtetues. Më konkretisht, Gjykata Supreme e Polonisë ka refuzuar ta njohë rekursin, pasi ky i fundit edhe pse është firmuar nga një avokat, sipas tyre, nuk ishte përpiluar/hartuar nga përfaqësuesi ligjor, por nga vetë rekursuesi, që në fakt ishte me profesion avokat. Sipas saj, "edhe pse në rastin konkret kërkuesi kishte respektuar formalisht nenin 526, paragrafi 2, të KPP-së, rekursi që avokati i tij kishte paraqitur në emër të tij nuk ishte hartuar nga ky avokat, por thjesht riprodhonte përmbajtjen e rekursit që i interesuari kishte hartuar vetë, dhe që i ishte refuzuar herën e parë, kur rekursuesi e kishte paraqitur vetë *(shih paragrafin 9 të vendimit Dylus*). Ndërsa GJEDNJ-ja ka vendosur se ka pasur shkelje ndaj ankuesit, jo sepse i ishte kërkuar firmosja nga një avokat, por sepse i ishte kërkuar edhe hartimi i rekursit nga avokati, përveç firmosjes, ndërkohë që rekursi si në formë dhe përmbajtje i plotësonte kriteret e cilësisë, dhe nuk kishte të dhëna subjektive në të. Specifikisht, Gjykata Supreme ka krahasuar rekursin e parë të nënshkruar nga vetë kërkuesi (avokat) me rekursin e dytë të nënshkruar nga një mbrojtës ligjor dhe ka dalë në konkluzionin se nuk është hartuar nga mbrojtësi, pasi në përmbajtje ishin të njëjtë. Kjo është arsyeja e refuzimit, pra hartimi i rekursit jo nga mbrojtësi ligjor, dhe jo nënshkrimi prej tij. GJEDNJ-ja këtë qëndrim të Gjykatës Supreme e ka konsideruar formalizëm të tepruar dhe jo proporcional me kriteret e aksesit në gjykatë (*përmbledhje e paragrafëve 40-46 të vendimit Dylus)*. Në çështjen në shqyrtim nuk jemi në të njëjtin kontekst rrethanash, pasi kërkuesit nuk e kanë paraqitur përsëri kërkesën të firmosur përmes një avokati dhe hipotetikisht t'u ishte refuzuar nga kancelari, pasi nuk ishte *hartuar* nga avokati mbrojtës, gjë e cila do t'i jepte vlerë dhe kuptim argumentit të shumicës për formalizëm të tepruar.

22. Në shtesë të kësaj analize, vlerësoj të risjell në vëmendje edhe qëndrimin e GJEDNJ-së, lidhur me rëndësinë e shterimit të mjeteve të brendshme të ankimit. Sipas kësaj gjykate: "*Në këto rrethana, Gjykata merr në konsideratë faktin se kishte, ende, të paktën një mjet efektiv në nivel kombëtar, të*

cilin mund ta kishin përdorur kërkuesit, më konkretisht, një padi në gjykatën e rrethit me mundësinë e ankimit në Gjykatën e Lartë. Veçanërisht në vështrim të faktit se Konventa është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Shqipëri, sipas nenit 122 § 1 të Kushtetutës, një ankim në gjykatat kombëtare, do t'u kishte dhënë atyre mundësinë të vlerësonin proporcionalitetin e zbatimit të aktit normativ të vitit 2012 në secilën prej çështjeve të kërkuesve..." *(Bakiu dhe të tjerë kundër Shqipërisë (vendim (dec.) i datës 10.4.2018, paragrafi 80)*. Më tej, GJEDNJ-ja shprehet: "*Për sa më sipër dhe duke pasur parasysh rrethanat e këtyre çështjeve, ajo nuk konstaton se ka pasur arsye të veçanta për të përjashtuar kërkuesit nga kërkesa për shterimin e mjeteve të brendshme në përputhje me ligjin kombëtar. Përkundrazi, nëse kërkuesit do e kishin respektuar këtë kërkesë, kjo do u kishte dhënë gjykatave kombëtare mundësinë që të vendosnin për çështjen e përputhshmërisë së masave kombëtare të kundërshtuara, ose të mosveprimit, me Konventën dhe, nëse kërkuesit do ta kishin paraqitur gjithsesi çështjen në Gjykatën Evropiane, kjo Gjykatë do të kishte pasur përfitimin e qëndrimeve të gjykatave kombëtare. Në këtë mënyrë, kërkuesit dështuan të ndiqnin hapat e duhur për t'i dhënë mundësinë gjykatave kombëtare që të përmbushnin rolin e tyre thelbësor në sistemin e mbrojtjes së Konventës, atë që Gjykata Evropiane është subsidiare e tyre.*" *(po aty, paragrafi 81*). Po ashtu, GJEDNJ-ja ka theksuar se: *"Qëllimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike është t'i japë një shteti kontraktues mundësinë e adresimit dhe, në këtë mënyrë, të parandalimit ose rregullimit të shkeljes në fjalë të Konventës që pretendohet kundër tij. Është e vërtetë që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës nuk është gjithmonë e nevojshme që Konventa të përmendet qartazi në proceset e brendshme, me kusht që pretendimi të ngrihet "të paktën në substancë". Kjo do të thotë që kërkuesi duhet të ngrejë argumente ligjore me të njëjtin efekt ose të ngjashëm në bazë të ligjit të brendshëm, në mënyrë që t'u japë gjykatave vendase mundësinë për të ndrequr shkeljen e pretenduar. Sidoqoftë, siç shpjegohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës, për t'i dhënë vërtet një shteti nënshkrues të Konventës mundësinë e parandalimit ose korrigjimit të shkeljes së pretenduar, kërkohet që të merren parasysh jo vetëm faktet, por edhe argumentet ligjore të kërkuesit për të përcaktuar nëse ankimi i paraqitur në Gjykatë me të vërtetë ishte ngritur paraprakisht, në substancë, përpara organeve vendase (Xhoxhaj kundër Shqipërisë, vendim 9 shkurt 2021, § 249*). Për rrjedhojë, mbështetur edhe në këtë jurisprudencë, vlerësoj se fillimisht janë gjykatat e zakonshme ato që duhet të vlerësojnë dhe shprehen për pretendimet e kërkuesve për qasjen formaliste të kancelarit të Gjykatës së Lartë dhe zbatimit prej tij të dispozitave përkatëse të KPC-së, me qëllim që pastaj Gjykata Kushtetuese të jetë në pozita që ta ushtrojë kontrollin e saj në mënyrë më efektive.

23. Po ashtu, theksoj se në një kërkesë të ngjashme me këtë në shqyrtim, është mbajtur në Kolegj (pjesë e të cilit kam qenë dhe unë), qëndrimi se pretendimet e kërkuesit për veprimet e kancelarit të Gjykatës së Lartë kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e të cilave i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme dhe jo atij kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji ka vlerësuar se për ankimin që ka bërë kërkuesi para kësaj Gjykate kundër shkresës administrative të kancelarit të Gjykatës së Lartë, me argumentin e mungesës së kompetencës së tij, legjislacioni në fuqi parashikon mjete në dispozicion që kërkuesi mund t'i shfrytëzojë për të kundërshtuar veprimet e kancelarit të Gjykatës së Lartë, në mbrojtje të së drejtës dhe interesave të tij *(shih vendimin nr. 69, datë 19.4.2021 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 17)*.

B. *Për pretendimin për konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin e tejzgjatjes, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave, si dhe shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë*

24. Nga sa më lart, rezulton se kërkuesit nuk e kanë kundërshtuar shkresën e kancelarit dhe nuk kanë paraqitur kërkesë të re për përshpejtimin e procesit, të firmosur me përfaqësues ligjor, për rrjedhojë ata nuk kanë të regjistruar asnjë kërkesë për përshpejtim pranë Gjykatës së Lartë.

25. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se "Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, por ajo mund ta ushtrojë këtë kompetencë, duke analizuar faktet e natyrës kushtetuese" *(shih vendimin nr. 18, datë 31.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në vlerësimin tim, mospasja e një kërkese të regjistruar për përshpejtim të procesit pranë Gjykatës së Lartë përbën fakt të natyrës kushtetuese që nuk mund të kapërcehej, ndaj mungesa e saj duhet të sillte moslegjitimim të kërkuesve për mosshterim të mjetit juridik, në të kundërt të sa ka argumentuar shumica për këtë element *(shih paragrafin 30 të vendimit*).

26. Duke konsideruar se kërkuesit nuk kanë pasur kërkesë të regjistruar për përshpejtim të procesit pranë Gjykatës së Lartë, nuk mund të merret në konsideratë pretendimi për konstatimin

e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme, përshpejtimin e procedurave dhe dëmshpërblimin. Ky rast është i ndryshëm, nga çështja me kërkues, shoqërinë "Zyra e Përmbarimit privat ARB", ku kërkuesi kishte të regjistruar kërkesën për përshpejtim dhe sipas Gjykatës së Lartë ajo ndodhej në fazë studimi. (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se: "Megjithatë, Gjykata nuk është e bindur se një kërkesë për përshpejtimin e procedurës do të kishte qenë efektive në rrethanat e çështjes. Edhe nëse supozojmë se kërkuesi i dytë do të kishte bërë një kërkesë për përshpejtimin e procedurës, funksionimi i Gjykatës së Lartë ishte dëmtuar aq seriozisht nga dorëheqja dhe shkarkimi i gjyqtarëve të saj nga detyra (shih paragrafin 25 më lart), sa që më 31 korrik 2018, kjo Gjykatë, e përbërë nga një trupë gjyqësore e ndryshme nga ajo së cilës i ishte caktuar shqyrtimi i rekursit, nuk do të kishte qenë në gjendje ta shqyrtonte atë për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve (shih paragrafët 25 dhe 33 më lart). (...) Në këto rrethana të jashtëzakonshme të kërkesës në fjalë, rezulton se pretendimi i Qeverisë bazuar në mosparaqitjen e një kërkese për përshpejtimin e procedurës para Gjykatës së Lartë nga ana e kërkuesit të dytë, duhet të rrëzohet" (*Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, vendim i datës 12 tetor 2021, § 79*).

28. Në një interpretim *a contrario*, të sa më lart, vlerësoj se kërkuesit nga muaji shkurt i vitit 2021 kur kancelari i ktheu kërkesën pa veprime, si dhe që nga muaji mars i vitit 2021, kur në Gjykatën e Lartë u krijuan disa kolegje, mund të kishin paraqitur kërkesë për përshpejtim pranë kësaj gjykate, e cila *potencialisht* mund ta shqyrtonte, dhe në një moment të caktuar vonese kërkuesit do të mund të kishin ngritur pretendime për mungesën e mjetit efektiv për përshpejtim pranë Gjykatës Kushtetuese, pra pasi të kishin regjistruar kërkesën për përshpejtim pranë Gjykatës së Lartë dhe mosmarrja në shqyrtim e saj të vazhdonte për një periudhë kohe dukshëm me një vonesë të tillë, që mjeti do të mund të humbte qëllimin përshpejtues (*shih vendimin nr.33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas standardeve të kësaj gjykatë, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së *në parim* janë efektive, ndërsa për sa i takon efektivitetit të tyre në praktikë, ato duhen shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 36).*

29. Në këtë kontekst, *së pari,* kërkuesit duke mos pasur një "kërkesë të regjistruar për përshpejtim", nuk e kanë ushtruar *de facto* mjetin juridik në dispozicion; së *dyti*, ata duhet ta kishin testuar efektivitetin e mjetit para Gjykatës së Lartë, dhe *së treti,* t'i jepnin mundësinë edhe kësaj Gjykate ta shqyrtonte efektivitetin e tij. GJEDNJ është shprehur se për të qenë efektiv, mjeti juridik duhet të jetë në gjendje të korrigjojë menjëherë gjendjen e cenuar dhe të ofrojë premisa të arsyeshme suksesi. Megjithatë, thjesht prania e dyshimeve në lidhje me mundësitë për suksesin e një mjeti specifik, i cili është dukshëm i pavlerë, nuk është një arsye e vlefshme për mosshterimin e asaj forme korrigjimi (*shih Vučković dhe të tjerët k. Serbisë [DHM], § 69–77, 25 mars 2014 dhe Bakiu k. Shqipërisë, § 80, 10 maj 2018*). Nga ana tjetër, pikërisht moshterimi i mjetit të përshpejtimit për gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë sipas nenit 399/5 të KPC-së, passjell dhe mosmarrjen në konsideratë të pretendimit për tejzgjatje të gjykimit të çështjes pranë kësaj gjykate, ku kërkuesit janë palë.

30. Analiza e mësipërme, sikundër parashtrova edhe më lart, u përket kritereve paraprake, ndryshe nga shumica, e cila pasi ka konsideruar kriterin e shterimit të mjetit juridik si të plotësuar, dhe i ka shkarkuar kërkuesit nga ky detyrim, ka vlerësuar pretendimin për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, duke analizuar me radhë kriteret jurisprudenciale të tejzgjatjes dhe zbatimin e tyre në rastin konkret (*shih paragrafët 35–63 të vendimit).*

31. Si përfundim, në kuptim të normave kushtetuese, standardeve jurisprudenciale të kësaj gjykate, rrethanave konkrete të çështjes, dhe fakteve të paraqitura në seancë gjyqësore nga kërkuesit, ata nuk legjitimohen, ndaj dhe kjo duhet të kishte qenë dhe arsyeja e rrëzimit të kërkesës.

Anëtare: Elsa Toska